



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Tetor, 2025

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit tetor 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT TETOR 2025

Gjatë muajit tetor 2025 janë raportuar 12,879 raste me sëmundje ngjitëse Inc.(722.68 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (19,013 raste apo Inc 1,066.88 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Influenca sezonale (ILI) me 5,639 raste ose 316,42/100,000 banorë, Diare ac. me 5,276 raste ose 296.05/100,000 banorë dhe ARI/ITPR me 1,021 raste ose 57.29 në 100,000 banorë (Tab.1).

Gjatë muajit tetor 2025 janë raportuar 9 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 4 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse, 3 raste me COVID-19 me diagnozë përcjellëse, 1 rast me dg. Meningoencephalitis ac. me diagnozë përcjellëse, dhe 1 rast me dg. Bronchopneumonia me diagnozë përcjellëse.

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuara në Kosovë, tetor 2025 krahasuar me tetor 2024

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuara në Kosovë 01 - 31 tetor të vitit 2024 dhe 2025				
Sëmundjet/shkaktarët	Tetor, 2024		Tetor, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100,000	Nr.	Incidenca/ 100,000
COVID-19	11	0.62	9	0.51
ITPR - Pneumonia/ARI	1490	83.61	1021	57.29
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	21	1.18	11	0.62
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	9608	539.13	5639	316.42
Influenca A	3	0.17	4	0.22
RSV	0	0.00	25	1.40
Infeksionet streptokoksike të gr. A	0	0.00	9	0.51
Diarea acute	7286	408.84	5276	296.05
Variçela	386	21.66	456	25.59
Sindromi meningjeal	11	0.62	16	0.90
EHSV	0	0.00	0	0.00
Helmimet me ushqim	41	2.30	128	7.18
Rota virus	14	0.79	12	0.67
Salmonella enteritidis	11	0.62	1	0.06
Shigelloza	0	0.00	0	0.00
Adenovirus	0	0.00	4	0.22
Enterovirus	0	0.00	2	0.11
Clostridium difficile	2	0.11	3	0.17
Gastroenterokolitet	51	2.86	112	6.28
Hepatiti akut B	3	0.17	0	0.00
Hepatiti akut C	3	0.17	0	0.00
E.coli patogjene	0	0.00	6	0.34
Parotiti epidemik	1	0.06	1	0.06
Morbilli	0	0.00	1	0.06
Pertussis	11	0.62	0	0.00
Tularemia		0.00	1	0.06
Brucelosis	6	0.34	2	0.11
Toxoplasmosis	0	0.00	0	0.00
WNV	0	0.00	0	0.00
Sëmundja Lyme	1	0.06	2	0.11
HIV/AIDS	2	0.11	2	0.11
IST	22	1.23	33	1.85
TB	0	0.00	40	2.24
Giardiaza	1	0.06	3	0.17
*Sëmundjet tjera ngjitëse	28	1.57	60	3.37
Gjithsej	19013	1066.88	12879	722.68
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Erysipella, Mykozat, Mononucleoza				

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, TETOR 2025

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit tetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 5,639 raste me ILI (Inc. 316.42/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 41.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (9,608 raste) por krahasuar me muajin paraprak, shtator 2025 me (4,759 raste të raportuara me ILI) rritje prej 18.49%, si rrjedhojë e faktorëve si: qarkullimi i viruseve respiratore edhe jashtë sezonit (p.sh. adenoviruse, rinoviruse, SARS-CoV-2), grumbullimeve masive gjatë pushimeve verore, rritjes së lëvizjeve (turizmi, migracioni).

Diarea akute: Gjatë muajit tetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 5,276 raste me diare akute (Inc.296.05/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (7,286 raste), vërehet një ulje prej 27.59% dhe gjithashtu krahasuar me muajin shtator 2025, me 10,922 raste të raportuara, ulje prej 51.7% e rasteve të raportuara. Megjithatë numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë gjatë kësaj periudhe të vitit.

ARI/ITPR: Gjatë muajit tetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 1,021 raste me ARI (Inc.57.29/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (1,490 raste) vërehet ulje prej 31.47 % e numrit të rasteve të raportuara por krahasuar me muajin paraprak shtator 2025 me (875 raste), rritje prej 16.69%.

Variçella: Gjatë muajit tetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 456 raste me Variçellë (Inc.25.59/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (386 raste) vërehet rritje prej 18.13% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak shtator 2025 me 210 raste të raportuara, rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve të raportuara.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit tetor 2025, nga rastet e raportuara si te dyshimta në fruth, vetëm 1 rast ka rezultuar pozitiv. Rasti është mashkull, nga komuna e Prishtinës, i përket grupmoshës 0-1 vjet (6 muajsh) dhe nuk është i vaksinuar me MMR sepse ende nuk e ka arritur moshën. Gjatë muajit tetor 2025 në laboratorin e mikrobiologjisë në IKShPK nga të gjitha mostrat e testuara për Parotit, Pertussis dhe Rubellë, nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv.

Në Klinikën Infektive gjatë muajit tetor në në mënyrë ambulatorike janë trajtuar 39 raste me dg.Ekzantemë in obs. Nga raportimet manuale janë raportuar 44 raste me ekzantemë in obs.Gjithesj 83 raste.Prej tyre vetëm, 3 raste janë hospitalizuar në Kl.Infektive. Sipas komunave: Fushë Kosovë (2 raste), Malishevë (1 rast).

Zoonozat dhe sëmundjet transmisive

Nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 2 raste me Brucellozë dhe 1 rast me Tularemi. Sipas komunave rastet me Brucellozë: Rahovec (1 rast) dhe Prizren (1 rast). Nga anketimi epidemiologjik i rasteve me Brucellozë, rezulton se të dy rastet janë sporadike dhe pa ndonjë lidhshmëri epidemiologjike. Mhojnë kontaktin me kafshë dhe pohojnë se përdorin qumështin dhe produktet e qumështit të blera në treg nga shitës ambulantor. Për rastet janë njoftuar zyret regionale të AUV. Sipas gjinisë, 1 rast i përket gjinisë femërore dhe 1 rast gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës: 50–59 vjeç (1 rast) dhe 30–39 vjeç (1 rast). Rasti pozitiv me Tularemi është nga komuna e Ferizajit, i përket gjinisë mashkullore dhe i takon grupmoshës 40–49 vjeç.

Gjatë muajit tetor janë raportuar 2 raste me *Borrelia burgdorferi*, prej të cilave sipas komunave të dy rastet i takojnë komunës së Prishtinës. Sipas grup-moshës: 60-69 vjeç (1 rast) dhe 0-9 vjeç (1 rast). Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast i takon gjinisë mashkullore dhe 1 rast gjinisë femërore.

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit tetor, 2025 janë raportuar 16 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.89/100 000 banorë), prej tyre 14 raste me Meningjit akut viral dhe 2 raste me Meningjit bakterial. Ky numër i rasteve të raportuara është pak më i lartë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara 11 raste.

Sipas komunave, janë raportuar 4 raste në komunën Prishtinë, me nga 2 raste në komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë, kurse me nga 1 rast komunat: Gjilan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Kaçanik, Lipjani, Podujevë, Suharekë dhe Viti, kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Fushë Kosovës, Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Kaçanik me 3/100,000 banorë. Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup-moshës 0-9 vjeç me 37.5% (6 raste), grup moshat: 10-19 vjeç, 30-39 vjeç, 50-59 vjeç, me nga 2 raste (12.5), kurse grup moshat: 20-29 vjeç, 40-49 vjeç, 60-69 vjeç dhe 70-79 vjeç me 6.25% (1 rast). Sipas gjinisë, rezulton se 62.5 % (10 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe të gjinia femërore me 37.5 % (6 raste).

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 8 shkaktarë në LCS, prej tyre: me nga 2 raste HHV7 dhe Varicela Zoster Virus, kurse me nga 1 rast *Streptococcus agalactiae*, *Staphilococcus spp.*, HHV1 dhe HHV8. Gjatë kësaj periudhe është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningoencephalitis ac, 55 vjeç, e gjinisë femërore nga Mitrovica me dg. përcjellëse si: Post ICV ischemica, DMT2, Insufficienca cardiorespiratoria, Gangrena re. Calcanei lat.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit tetor 2025, përmes SMSN nga të gjitha regjionet janë raportuar gjithsej 1,479 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 1,440 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (A09); 15 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (A04.8); 8 raste me dg. Intoksikacionet tjera alimentare bakteriale (A04.9); 9 raste me dg. Infeksion nga *Escherichia coli* prodhues i toksinës Shiga dhe/ose verocitotoksinës (STEC/VTEC, EHEC), Sindrom uremik hemolitik (*Escherichia coli*) (B96.22); 7 raste me dg. Giardiasis (*Giardia lamblia*) (A07.1).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

12 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 8 raste Prishtinë, 2 raste Rahovec dhe nga 1 rast Mitrovicë dhe Gjakovë. Sipas grup moshave: 10 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe 2 raste të grup moshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 8 raste të gjinisë femërore.

4 raste me Adenovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Gjakovë dhe nga 1 rast Prishtinë dhe Mitrovicë. Sipas grup moshave: 4 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 3 raste të gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore.

3 raste me Clostridium difficile, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë dhe 1 rast Vushtrri. Sipas grup moshave: 2 raste janë të grup moshës 20-29 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 50-59 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast është i gjinisë mashkullore dhe 2 raste të gjinisë femërore.

2 raste me Enterovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë. Sipas grup moshave: 2 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të 2 rastet janë të gjinisë mashkullore.

1 rast me Salmonella enteritidis, nga komuna e Prishtinës. Rasti është i gjinisë femërore dhe grup moshës 50-59 vjeç.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit tetor 2025, janë testuar 310 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 4 raste me Influcencë A dhe B apo pozitivitet prej 1.29%. Sipas tipit: Të gjitha rastet pozitive janë me Influcencë A (4 raste apo 1.29%). Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 25 (8.06%) mostra pozitive me RSV, 71 (22.9%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 39 (12.58%) mostra pozitive në Human Adenovirus dhe 9 (2.9%) mostra pozitive në Parainflucenca Virus.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC, WHO për sezonën 2025/2026 si dhe Buletin javor për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për muajin tetor 2025 paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit me fillim të qarkullimit të virusit të Influcencës A për këtë sezonë.

Gjatë muajit tetor 2025 në IKSHPK janë raportuar 11 raste me SARI (Inc.0.62/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (21 raste) vërehet rënie e numrit të rasteve prej 47.6% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (13 raste), rënie prej 15.4%. Të gjithë këta pacientë, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Prej tyre rezultuan vetëm 4 mostra pozitive në SARS-CoV-2. Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (6 raste), Ferizaj (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Lipjan, Shtime dhe Viti. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (9 raste) dhe me nga 1 rast grup-mosha 35-50 dhe 51-64. Sipas gjinisë, 8 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 3 gjinisë femërore.

Gjatë muajit tetor 2025, janë raportuar 6 raste të vdekjes me SARI (CFR=54.5). Rastet e vdekjes i takojnë komunave si : Prishtinë (3 raste), Ferizaj (1 rast), Lipjan (1 rast) dhe Shtime (1 rast). 4 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 2 gjinisë femërore, grup-mosha 65+, me sëmundje shoqëruese.

Në SMSN, gjatë muajit tetor 2025, janë raportuar 40 raste me Tuberkuloz apo 2.24 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Ferizaj (7 raste), Drenas (5 raste), Lipjani dhe Gjilani me nga (4 raste), Prishtinë dhe Klinë me nga (3 raste), me nga (2 raste) komunat: Kaçanik dhe Shtime, kurse komunat si: Pejë, Gjakovë, Fushë Kosovë, Istog, Han i Elezit, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Viti dhe Suharekë me nga (1 rast). Prej 40 rasteve të raportuara, 33 (82.5%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 7 (17.5%). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 23 raste (70%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup- mosha më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 10 raste apo (25%), 20-29 vjeç dhe 50-59 vjeç me nga (7 raste), 30-39 vjeç me 5 raste, grup mosha 40-49 vjeç (4 raste), 70-79 vjeç (3 raste), 80-89 vjeç me (2 raste), kurse grup

moshat 0-5 vjeç dhe 15-19 vjeç me nga 1 rast. Sipas gjinisë, rezulton se gjinia mashkullore femërore me 47.5% (19 raste) kurse 52.5 % (21 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

Rastet me HIV/AIDS/IST

Gjatë muajit tetor 2025, janë raportuar 2 raste me HIV.

Rastet janë të gjinisë mashkullore. Një i takon grup moshës 25- 34 vjeç, rasti tjetër 35-44 vjeç. Të dyja rastet janë nga komuna e Prizrenit, janë në terapi ARV dhe janë të raportuara përmes SMSN/Klinika Infektive. Një rast rrugën e transmissioinit e ka heteroseksuale dhe rasti tjetër i takon komunitetit MSM.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)

Gjatë muajit tetor 2025 janë raportuar gjithsej 33 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme.

Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 9, Pejë 6, Prishtinë 4, Gjakovë 3, Prizren 3, Viti 1, Suharekë 1, Rahovec 2, Deçan 1, Istog 1, Komoran 1 dhe Lipjan 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 16 raste, Condyloma 12, Gonorrhoeae 3, HPV 1 dhe Mollusca contagiosum një. Sipas gjinisë: 22 (67%) i takojnë gjinisë femërore dhe 11 (33%) gjinisë mashkullore. Sipas grup moshës: 25-49 vjeç 26 raste (79%), 15-24 vjeç 4 raste (12%), dhe tre raste mbi 50 vjeç (9%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit tetor, nuk është raportuar asnjë rast me Hepatit akut B dhe Hepatit akut C.

Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, tetor 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave Tetor 2025																																		
SËMUNDJA	KOMUNA	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarrhea	Varicella	Influenca A	RSV	COVI D-19	Sindroma			**Morbilli	Parotitis epidemica	Helmi me ushqim	Gastroenterokolitet	Brucella	Tularemia	Salmonella	E.coli	Rotavirus	Boreliosa (Lyme Disease)	Adenovirus	Enterovirus	Clostridia	IST	HIV	TB	Giardia	Infeksionet streptokok të gr. A	Sëm.tjerat ngjitëse	Totali		
										Menjigjithë	Menjigjithë	Menjigjithë																						
DEÇAN		5		73	88	7									8	1																		183
DRAGASH		3		14	10	2										1																		30
DRENAS		21		31	22	4			1						3	2										1			5				90	
F. KOSOVË		3		31	18	6		8	1	1					11	3												1					84	
FERIZAJ		33	2	195	287	26	1		1	1					1	7									9			7			1	571		
GJAKOVË		9	0	211	105	2		1							8	3				6	1		2			3		1	3	9	2	366		
GJILAN		19		105	196	6		1		1						1												4				333		
GRAÇANICË																																	0	
H. I ELEZIT		8		31	8	0																						1					48	
ISTOG		4		108	66	1									5	1										1		1					187	
JUNIK		0		5	2																												7	
KAÇANIK		5		38	36	4										1													2				87	
KAMENICË		2		284	160	0																											446	
KLINË		51		145	150	22																											373	
KLLOKOT															2																		0	
LEPOSAVIQ																																	0	
LIPJAN		1	1	84	66	3				1					1	6											1		4				168	
MALISHEVË		0	0	34	51	3		1								6																	95	
MAMUSHË		0		18	49	3																											70	
MITROVICË		50	0	386	443	66							2		1	3	11				1		1								9	973		
MITROVICË E VERIUT																																	0	
N. BËRDË		0		23	14	0																												37
OBILIQ		0	0	92	49	19									1	1												1					163	
PARTESH																																		0
PEJË		12		814	496	24									43	2										6							1398	
PODUJEVË		29		233	185	10		1		1					3	3		1															487	
PRISHTINË		634	6	1032	1474	140	2	13	5	3	1		1		15	36				1	8	2	1	2	2	2	4		3		4	3389		
PRIZREN		68		777	647	53									3	17	1														3	1574		
RAHOVEC		4	0	117	60	8										1	1				2						2		1			2	198	
RANILLUG																																		0
SHTËRPCE																																		0
SHTIME		10	1	180	64	1				1																			2				259	
SKËNDERAJ		1	0	41	93	6										2	1																141	
SUHAREKË		10		376	221	22									1	3											1		1				636	
VITI		1	1	97	110	9	1			1					1	1																	221	
VUSHTRRI		38	0	44	106	9									1		1															38	256	
Z. POTOK																																		0
ZVEÇAN																																		0
PAADRESE																3																		3
TOTALI		1021	11	5639	5276	456	4	25	9	12	1	3	1	1	128	112	2	1	1	6	12	2	4	2	3	33	2	40	3	9	60	12879		

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

** Raste të importuara: Malaria, Mpox, Morbilli

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, TETOR 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga exanthemat, pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatrië dhe spitalet e përgjithshme, tetor 2025

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	147
SARI	11
Sindroma meningjeale	16
Helmimet me ushqim	17
Diarea akute dhe gastroenterocolite	139
Status febrilis	15
Exanthema	83
Mononucleosis	6
Erysipela	8
Vulnus morsum viperi	1
Total	443

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT TETOR 2025

Epidemi e helmimit me ushqim në Vitomiricë të Pejës

Më datë 21.10.2025 QRSHP Pejë është njoftuar nga Inspektorati Sanitar për disa raste të dyshimta në helmim me ushqim, nxënës të SHFMU “7 Shtatori” në Vitomiricë, Pejë. Nxënësit që kishin shfaqur simptome të sëmundjes: marramendje, mundim, vjellje, dhembje barku dhe dhembje koke kishin konsumuar ushqim në pauzë të gjatë rreth orës 9-9.20 në piceritë afër shkollës: “N.N.”, kurse simptomat iu kanë filluar rreth orës 10.00 e tutje. Hulumtimi epidemiologjik u realizua nga ekipi i QRSHP Pejë dhe ekipi i Inspektoratit Sanitar, rastet u raportuan nga QMF Vitomiricë dhe nga menaxhmenti i SHFMU “7 Shtatori” në Vitomiricë të komunës së Pejës. Disa pacientë u intervistuan direct në shkollë kurse disa tjerë përmes telefonit. Nga përafërsisht 130 persona që kanë konsumuar ushqim në 2 piceri “N.N.”, me date 21.10.2025, janë intervistuar 39 nxënës (30%), prej tyre 21 (53.8%) ishin të gjinisë femërore dhe 18(46.2%) të gjinisë mashkullore, të grupmoshës 10-14 vjeç. Nga 39 nxënësit e anketuar 17 kanë shfaqur simptome të sëmundjes sipas definimit të rastit me shkallë të përgjithshme të sulmit AR 13.1%. Rastet e para fillojnë të kenë simptome 1 orë pas konsumimit të ushqimit, aty rreth orës 10.00, piku vërehet rreth orës 11.00 të të njejtës ditë dhe pastaj rastet fillojnë të bijnë në orët e mbasditës. Koha mesatare e inkubacionit ishte 2.3 orë (min 40 min, max 6.6 orë). Gjinia mashkullore ishte më prekur me 10 raste (58.8%), kurse mosha më e prekur ajo 11 vjeçare me 9 raste (52.9%), mosha minimale 10 vjeç, kurse ajo maximale 14 vjeç (mosha mesatare 11.7 vjeç). Sa i përket simptomave të sëmundjes, 16 apo 94.1% kishin dhembje barku, 13 apo 76.5% mundim dhe vjellje, 9 apo 52.9% diare ujore dhe 3 apo 17.6% temperature të lartë/ethe. Nga 17 rastet e anketuara 9 (52.9%) janë trajtuar në QMF Vitomiricë, kurse asnjë rast nuk është hospitalizuar. Poashtu sipas të dhënave nga analizat statistikore nuk vërehet dallim significant sa i përket ushqimit të konsumuar në mes rasteve dhe grupit kontroll të analizuar në përgjithësi.

Të gjeturat laboratorike: Në kuadër të masave të ndëmarra janë kryer analiza edhe të punonjësve në dy piceritë.. Nga 6 punonjësit e testuar, në një mostër (16.6%) është izoluar *Staphylococcus aureus* në hundë në picerinë “N.N.”. Të gjeturat nga sudimet e ambientit: Gjatë inspektimit të picerive me datë 21.10.2025 janë marrë 14 mostra-strisho sipërfaqësore: nga duart e kuzhinjerëve dhe nga sipërfaqet dhe mjetet e punës në kuzhinë. Nga 8 mostrat e marra në picerinë “N.N.”, 6 apo 75% kanë rezultuar të kontaminuara dhe atë nga duart e kuzhinjerit *Staphylococcus aureus*, kurse nga sipërfaqet e punës 2 *Staphylococcus aureus*, 2 *Serratia marcescens* dhe 1 *Klbesiella pneumoniae*. Kurse në picerinë tjetër “N.N.”, nga 6 mostra-strisho sipërfaqësore, 3 apo 50% kanë rezultuar të kontaminuara: nga duart e kuzhinjerit *Staphylococcus aureus* dhe nga sipërfaqet e punës 1 *Staphylococcus aureus* dhe 1 *Enterococcus spp.* Me datë 28.10.2025 janë përsëritur prap mostrat, pas kryerjes së dezinfektimit të objekteve dhe prap disa mostra kanë rezultuar të kontaminuara. Në picerinë “N.N.”, janë marrë 6 mostra prej tyre 2(33.3%) të kontaminuara me *Staphylococcus aureus*, kurse në picerinë Jonas janë përsërit 3 mostra, prej tyre 1(33.3%) ka rezultuar e kontaminuar me *Enterobacter spp.* Limitimet: Për shkak se në momentin e inspektimit nuk u moren mostra ushqimi dhe as mbetje të ushqimit të përgaditur dhe servuar, atëherë ishte e pamundur që të izolohet shkaktari në ushqim, por të bazohet vetëm në studime analitike. Pacientët nuk kanë sjellë mostra, atëherë edhe izolimi i shkaktarit ka qenë i pamundur. Konkluzionet: Rezultatet e mostrave sipërfaqësore sugjerojnë që personeli nuk ka respektuar principet themelore të higjienës gjatë punës si pastrimi i sipërfaqeve të punës, higjiena e duarve, përgaditja dhe ruajtja e duhur e ushqimeve që mundëson paraqitjen e rasteve dhe epidemive të helmimeve me ushqim.

5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, tetor 2025


KOMUNA	KOPJE FIZIKE										SMSN										
	Sptali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Sptali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionet Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DECAN							84		27	111						2		55	3		60
DRAGASH							16	13		29								6			6
DRENAS							109			109								111	32	112	255
F.KOSOVË							84		49	133								69	30	45	144
FERIZAJ	11						81	197		289						3		29	15		47
GJAKOVË										0	52					32		210	77		371
GJILAN	7						208			215											0
GRACANICË										0											0
HIJELEZIT							46			46								2			2
ISTOG						1	56	64		121						0		43	11	2	56
JUNIK										0								7			7
KACANIK							80			80								14			14
KAMENICË							352			352											0
KLINË							342		2	344				1				7	9	2	19
KLOKOT										0											0
LEPOSAVIQ										0											0
LIPJAN										0								145	10		155
MALISHEVË										0						3		73	4		80
MAMUSHË							70			70								43			43
MITROVICË	318						179	158	10	665								52	4		56
MITROVICË V.										0											0
N.BËRDË							28			28											0
OBILIQ										0								106	41	5	152
PARTESH										0											0
PEJË	17					6	248	783	203	1257	135	2	1				2	19	13	1	173
PODUEVË							429	5	16	450								110	26		136
PRISHTINË		139	245				190	1574	286	2434		32	7	3		9	10	768	3	2	834
PRIZREN	42					8	725	647	79	1501	38					1		41	171	0	251
RAHOVEC										0						12		68	52	54	186
RANILLUG										0											0
SHTËRPCE										0											0
SHITËME							80	174		254								7			7
SKËNDERAJ						0	78	26	0	104								39			39
SUHAREKË						63	206	293	68	630						1		146			147
VITI							176			176											0
VUSHTRRI	47					0	27	37	2	113	27		29	0	0		14	58	0	0	128
Z.POTOK										0											0
ZVEÇAN										0											0
Gjithsej	442	139	245	0	0	78	3894	3971	742	9511	252	34	37	3	1	63	26	2228	501	223	3368

Gjatë muajit tetor 2025, përmes SMSN janë raportuar gjithsej 3,368 raste me sëmundje ngjitëse dhe krahasuar me numrin e rasteve të raportuara me kopje fizike është 26.15 % i të gjitha rasteve të raportuara. (Tabela 4).

6. COVID-19

Gjatë muajit tetor 2025, janë testuar gjithsej 547 mostra të dyshimta për COVID-19, prej të cilave janë konfirmuar 9 raste pozitive me SARS-CoV-2, me një shkallë pozitiviteti prej 1.6%. Nga këto raste, 16 pacientë janë shëruar. Gjatë muajit tetor 2025 janë raportuar 3 raste të vdekjes me COVID-19 dhe të gjitha rastet e raportuara i takojnë grup-moshës 65+ me sëmundje përcjellëse.

Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara/konfirmuara me COVID-19, Gusht 2025



Sipas komunave, numri më i madh i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës (5 raste), ndërsa me nga 1 rast komunat : Fushë Kosovë, Drenas, Shtime dhe Ferizaj. Sipas grup-moshës, 60–69 vjeç (3 raste), grupmosha 70–79 vjeç me 2 raste dhe me nga 1 rast grup-moshat: 10–19 vjeç , 40–49 vjeç, 50–59 vjeç dhe 80+. Sipas gjinisë, 56% të rasteve i takojnë gjinisë femërore dhe 44% gjinisë mashkullore.

7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, TETOR 2025

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME PATOGJENË RESPIRATORË

Gjatë muajit tetor, pesë nga 31 vende dhe territore raportuese kanë shënuar nivele të rritura të raportimit të sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksioneve akute të rrugëve të frymëmarrjes (ARI), mbi nivelet bazë për këtë sezonë. Edhe pse aktiviteti i gripit mbetet nën pragun epidemik sezonal, shumica e treguesve kanë shënuar rritje graduale nga nivelet ndërsezonale, me disa vende që raportojnë rritje më të theksuara të aktivitetit të gripit. Në nivel rajonal, aktiviteti i SARS-CoV-2 vijon një tendencë në rënie, megjithëse me variacione midis vendeve. Varianti XFG mbetet varianti dominues në qarkullim. Aktiviteti i RSV-së (virusit sincial respirator) mbetet në nivele të ulta në gjithë rajonin. Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin është mbi nivelin bazë në Austri dhe Kazakistan, ndërsa infeksionet akute të rrugëve të frymëmarrjes janë rritur mbi nivelin bazë në Gjermani, Lituani dhe Spanjë. Nga mostrat e marra në qendrat sentinel të ILI dhe ARI, përqindja e atyre që rezultuan pozitive për grip ishte 6%, nën pragun epidemik prej 10%, por me një rritje të lehtë krahasuar me javën e kaluar (5%). Mesatarja e vendeve që raportuan ishte 2%, ndërsa vetëm Irlanda e Veriut dhe Skocia (të dyja pjesë e Mbretërisë së Bashkuar) raportuan mbi 10% pozitivitet. Pozitiviteti për SARS-CoV-2 ra në 11% nga 13% një javë më parë, ndërsa për RSV mbeti i qëndrueshëm në 1%. Nga 128 imostra pozitive të virusit të gripit të raportuara këtë javë nga mbikëqyrja sentinel në kujdesin parësor, 98% ishin të tipit A, me një shpërndarje ndërmjet nën-tipeve A(H3) (59%) dhe A(H1)pdm09 (41%). Asnjë vend nuk raportoi intensitet të mesëm ose të lartë të gripit, ndërsa tre vende (Norvegjia, Spanja dhe Irlanda e Veriut) raportuan përhapje gjeografike rajonale ose të gjerë të virusit. Nga të dhënat e mbikëqyrjes sentinel për rastet SARI (infeksione të rënda akute të rrugëve të frymëmarrjes), 4% e mostrave rezultuan pozitive për virusin e gripit (krahasuar me 3% një javë më parë), 10% për SARS-CoV-2 (nga 8% më parë) dhe 1% për RSV. Shumica e mostrave pozitive të gripit në rastet SARI ishin të tipit A (97%), me nën-tipe të përziera midis A(H3) (55%) dhe A(H1)pdm09 (45%). Shkalla e vdekjeve nga COVID-19 mbetet e ulët në 41 vendet raportuese. Analiza e përbashkët javore e EuroMOMO për vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet në vendet pjesëmarrëse të Europës tregon nivele të pritura vdekshmërie në të gjitha grupmoshat.

Në përmbledhje, megjithëse aktiviteti i gripit dhe viruseve të tjerë respiratorë në rajonin europian mbetet në nivele nën pragun epidemik sezonal, po vërehet një rritje graduale në disa vende, që sugjeron fillimin e fazës së hershme të sezonit respirator.

MPOX

Që nga gushti 2024, në BE/EEA janë raportuar 30 raste të mpox të kladës I (kryesisht Ib), me përhapje në Belgjikë, Francë, Gjermani, Irlandë, Itali, Spanjë dhe Suedi. Janë identifikuar raste të transmetimit sekondar dhe disa raste pa lidhje udhëtimi, çka tregon për transmetim lokal në rrjetet seksuale të burrave që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra (MSM). Në total, deri më 9 tetor 2025 janë raportuar 59 raste të reja nga 8 vende të BE/EEA. Që nga fillimi i shpërthimit janë regjistruar 25 420 raste të konfirmuara dhe 10 vdekje në 29 vende. Në Ballkanin Perëndimor, mpox është raportuar në Serbi (40 raste), Bosnje e Hercegovinë (9), Mali i Zi (2), Maqedoni e Veriut (2), Shqipëri (1) dhe Kosovë (1), ndërsa në Turqi janë raportuar 71 raste. Shumica e rasteve në BE/EEA i përkasin kladës IIB, me profil të qëndrueshëm epidemiologjik – kryesisht të meshkujt dhe me transmetim përmes kontakteve seksuale MSM. ECDC vlerëson se rreziku nga klada Ib është i moderuar për MSM dhe i ulët për popullatën e përgjithshme, ndërsa rreziku nga klada IIB mbetet i ulët dhe shumë i ulët përkatësisht. Rekomandohet forcimi i mbikëqyrjes epidemiologjike, testimi, sekuencimit dhe gjurmimit të kontakteve, si dhe vaksinimi parandalues për grupet me rrezik të lartë. Përveç kësaj, kërkohet vigjilencë e vazhdueshme ndaj rasteve të mundshme të importuara dhe angazhim komunitar për rritjen e ndërgjegjësimit dhe pranueshmërisë ndaj vaksinimit. Aktualisht, situata e mpox në BE/EEA mbetet e qëndrueshme, me transmetim të kufizuar, por kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim ndër-rajonal për parandalimin e përhapjes së mëtejshme. Gjatë viteve 2024–2025, virusi i lisë së majmunit (MPXV) i kladave I dhe II është në qarkullim në disa vende të botës. Që nga viti 2022, klada II ka qarkulluar jashtë kontinentit afrikan, kryesisht në rrjetet e burrave që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra (MSM), ndërsa klada I është raportuar

kohët e fundit në disa vende jashtë Afrikës edhe pa histori udhëtimit, duke treguar për transmetim lokal të kufizuar. Në të dy kladat, kontaktet seksuale mbeten mënyra kryesore e përhapjes. Kladat II: Pas shpërthimit fillestar të vitit 2022, klada II vazhdon të qarkullojë globalisht, me rritje të rasteve në Afrikën Perëndimore (Gana, Guinea, Sierra Leone, Liberi). Jashtë Afrikës, shumica e rasteve janë raportuar te meshkujt (97%) dhe të rriturit (99%), me 89% që kanë raportuar kontakt seksual me burra. Në vendet afrikane me rritje të rasteve, transmetimi është vërejtur si te meshkujt, ashtu edhe te femrat, me kontaktet seksuale si faktor kryesor përhapjeje. Kladat I: Në Afrikë, deri në tetor 2025, shumica e rasteve të konfirmuara dhe të dyshuara të kladës I janë raportuar nga Republika Demokratike e Kongos (RDK), Uganda dhe Burundi, me rritje të fundit në Kenia, Republikën e Afrikës Qendrore dhe Tanzani. Uganda ka regjistruar mbi 6 000 raste në vitin 2025, përfshirë 37 vdekje. Në disa vende, si Burundi, rritjet kanë qenë të lehta dhe me luhatje javore. Raste të kladës I janë raportuar gjithashtu jashtë Afrikës, përfshirë vendet e BE/EEA (Gjermani, Belgjikë, Francë, Itali, Spanjë, Irlandë, Greqi) dhe në shumë vende të tjera si SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Turqi, Indi, Japoni dhe Australia. Disa raste janë pa histori udhëtimit, duke sugjeruar transmetim të kufizuar lokal, kryesisht në rrjete MSM. Rastet sekondare të konfirmuara jashtë Afrikës kanë qenë të pakta dhe pa raportime për vdekje.

WEST NILE VIRUS

Deri më 3 tetor 2025, 13 vende evropiane raportuan 989 raste lokale të infeksionit nga virusi i Nilit Perëndimor (WNV) dhe 63 vdekje. Rastet janë regjistruar kryesisht në Itali (714 raste), e cila po përjeton shpërthimin më të madh të këtij viti, me fokus në rajonet Lazio dhe Campania. Numri i rasteve është më i lartë se mesatarja e dekadës së fundit, por më i ulët se në vitet me qarkullim të fortë si 2018, 2022 dhe 2024. Pjesa më e madhe e rasteve janë meshkuj mbi 65 vjeç, me 88% të shtruar në spital dhe letalitet rreth 7%. Rreth gjysma e rasteve paraqiten me forma neurologjike. Nga ana veterinare, janë raportuar 127 shpërthime te kuajt dhe 217 te shpendët, kryesisht në Itali, Francë, Kroaci, Hungari dhe Gjermani. Belgjika raportoi për herë të parë prani të virusit te shpendët, duke treguar përhapje gjeografike të re të WNV në Evropë. Zgjerimi i zonave të prekura lidhet me kushtet klimatike dhe ekologjike që favorizojnë mushkonjat vektore, si dhe me rritjen e ndjeshmërisë së sistemit të mbikëqyrjes. Me afrimin e stinës së ftohtë, pritet ulje e rasteve në javët e ardhshme, ndërsa kulmi i transmetimit është regjistruar gjatë gushtit dhe shtatorit. ECDC dhe EFSA, në kuadër të qasjes “Një Shëndet” (One Health), vijnë mbikëqyrjen e përbashkët të rasteve te njerëzit dhe kafshët, për të mbështetur masat parandaluese dhe kontrollin e infeksioneve në Evropë.

EPIDEMIA E BOTULIZMIT TE FOSHNJET I GJURMUAR TE FORMULA BYHEART

Zyrtarët federalë dhe shtetërorë po hetojnë një shpërthim të botulizmit foshnjor të gjurmuar te pluhuri i formulës së markës ByHeart. Që nga 8 nëntori, kishte 13 pacientë të konfirmuar në 10 shtete: Arizona, Kalifornia, Illinois, Minesota, New Jersey, Oregon, Pennsylvania, Rhode Island, Teksas dhe Washington. Nuk është raportuar ende asnjë vdekje.

Administrata e Ushqimit dhe Barnave ka qenë në kontakt me kompaninë dhe ka rekomanduar një tërheqje. Kompania ra dakord dhe ka tërhequr dy lote të formulës ByHeart Whole Nutrition për foshnje — Loti: 206VABP/251261P2 dhe Loti: 206VABP/251131P2 — që u raportua se ishin konsumuar nga foshnjat e sëmura.

FDA po ndihmohet në hetim nga departamentet shtetërore të shëndetësisë dhe Programi i Trajtimit dhe Parandalimit të Botulizmit të Foshnjave (IBTPP). Departamenti i Shëndetësisë i Kalifornisë (IBTPP) raportoi një rritje të numrit të infeksioneve të botulizmit të tipit A tek foshnjat që konsumonin formulën pluhur për foshnje ByHeart nga gushti 2025 deri në tetor 2025. Të 13 pacientët e përfshirë në këtë shpërthim raportohet se kanë konsumuar formulën pluhur për foshnje ByHeart. Zyrtarët në disa shtete kanë mbledhur formulën e mbetur për foshnje për testim. Ky testim është duke u zhvilluar dhe rezultatet nuk janë ende të disponueshme, por priten në javët e vijim. Sipas një njoftimi të ByHeart, ByHeart u njoftua nga FDA në tetor 2025 për rreth 83 raste të botulizmit foshnjor që u raportuan në të gjithë vendin që nga gushti 2025. Nga këto, FDA gjithashtu vuri në dukje se 13 foshnje morën formulë ByHeart në një moment të caktuar. FDA nuk ka identifikuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis ndonjë formule foshnjore dhe këtyre rasteve dhe nuk ka precedent historik të formulës foshnjore që shkakton botulizëm foshnjor. Botulizmi është jashtëzakonisht i pazakontë në produktet e qumështit ose formulën foshnjore dhe ndodh natyrshëm në burime mjedisore si toka, perimet e zgjedhura dhe pluhuri.

ETHET E LUGINËS RIFT NË AFRIKËN PERËNDIMORE

Që nga 21 shtatori 2025, në Senegal janë raportuar 397 raste njerëzore (përfshirë 29 vdekje) të etheve së Luginës Rift (RVF). Që nga 27 shtatori 2025, dhe deri më 30 tetor, në Mauritani janë raportuar 46 raste njerëzore (përfshirë 14 vdekje) të RVF. Më 5 nëntor, media duke cituar zyrtarët e shëndetësisë raportoi një rast njerëzor të RVF në Gambia, afër kufirit me Senegalin. Të tre vendet kanë raportuar shpërthime midis kafshëve të gjalla. Deri më sot, nuk është dokumentuar asnjë transmetim i RVF nga njeriu te njeriu. RVF është një sëmundje akute virale që prek kryesisht kafshët shtëpiake (si bagëtia, bualli, delet, dhitë dhe devetë). Sëmundja shkaktohet nga virusi VVF, i cili gjendet përgjithësisht në rajonet e Afrikës lindore dhe jugore, por edhe në shumicën e vendeve të Afrikës Sub-Sahariane dhe Madagaskarit. Shpërthime janë raportuar gjithashtu në Arabinë Saudite dhe Jemen në fillim të viteve 2000. Njerëzit mund të infektohen përmes kontaktit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me gjakun ose organet e kafshëve të infektuara. Transmetimi i virusit mund të ndodhë edhe përmes vektorëve të mushkonjave. Ndërsa shumica e rasteve humane janë relativisht të lehta, një përqindje e vogël e pacientëve zhvillojnë një formë shumë më të rëndë të sëmundjes. Rastet e pakomplikuara karakterizohen nga sëmundje akute të ngjashme me gripin që çon në shërim të plotë. Tek disa pacientë sëmundja mund të përparojë në një formë të rëndë me manifestime hemorragjike dhe hepatit; ndërlikimet e mundshme përfshijnë retinitin dhe encefalitin. Në zonat endemike, vaksinimi i kafshëve në rrezik është masa më e rëndësishme për të parandaluar infeksionin tek njerëzit.

KOLERA

Që nga 1 janari 2025 dhe deri më 29 tetor 2025, janë raportuar 562 449 raste të kolerës, përfshirë 7 201 vdekje, në të gjithë botën. Që nga 2 maji 2025 dhe deri më 29 tetor 2025, janë raportuar 450 783 raste të reja të kolerës, përfshirë 5 642 vdekje të reja, në të gjithë botën. Pesë vendet që raportojnë më shumë raste të reja janë Afganistani (123 416), Jemeni (74 452), Sudani (62 315), Sudani i Jugut (53 602) dhe Republika Demokratike e Kongos (46 832). Pesë vendet që raportojnë më shumë vdekje të reja janë Sudani (1 749), Republika Demokratike e Kongos (1 507), Sudani i Jugut (862), Nigeria (468) dhe Angola (344). • Në vitin 2025, rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikë dhe Azi, Lindjen e Mesme dhe Amerikë. Rreziku i infeksionit me kolerë tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse importimi sporadik i rasteve në BE/EEA është i mundur.

8. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432
